

A K T N O R M A T I V

Nr.3, datë 19.9.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8553, DATË 25.11.1999 "PËR POLICINË E SHTETIT", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8933, DATË 25.7.2002 DHE NR.9089, DATË 26.6.2003

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", ndryshuar me ligjet nr.8933, datë 25.7.2002 dhe nr.9089, datë 26.6.2003, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

Neni 1

Në nenin 60/a të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, fjalët "... forcat e Policisë së Rendit dhe të Policisë së Objekteve ...", zëvendësohen me "... Policia e Shtetit ...".

b) Pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

"2. Ndalohet përdorimi i forcave të ndërhyrjes së shpejtë dhe atyre speciale në ruajtjen e qendrave të votimit."

c) Në pikën 4, fjalët "... i forcave të Policisë së Rendit dhe të Policisë së Objekteve ..." zëvendësohen me "... i strukturave të Policisë së Shtetit ...".

Neni 2

Neni 60/c ndryshon si më poshtë vijon:

"Neni 60/c

"1. Punonjësit e Policisë së Shtetit, të ngarkuar për ruajtjen e qendrave të votimit, për shoqërimin e kutive të votimit dhe të materialeve të votimit nga qendra e votimit në KZZV ose KZQV, janë të detyruar të mbajnë armatimin personal, armë brezi dhe automatik.

2. Punonjësit e policisë, që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve, 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe ditën e zgjedhjeve, qëndrojnë brenda komisariatit ose në vende të dislokuara, larg qendrave të banuara. Qarkullimi i tyre brenda territorit zgjedhor bëhet vetëm me automjetet e policisë."

Neni 3

Në nenin 60/ç pas fjalës "... përcaktohen ..." shtohen fjalët "... dhe të sigurohen ...".

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano